Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 6 dhjetor 2012

Lënda nr. 02/09

S. C.

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 6 dhjetor 2012, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
znj. Christine CHINKIN
znj Françoise TULKENS

Të ndihmuar nga:
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas konsiderimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit, nxjerr konstatimet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 15 janar 2009 dhe është regjistruar në të njëjtën datë.

2. Më 20 prill 2009, Paneli kërkoi informata të tjera nga ankuesja. Ankuesja u përgjigj më 18 maj 2009.

3. Më 9 qershor 2009, Paneli ia komunikoi lëndën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP)[1] në mënyrë që të merr komentet e UNMIK-ut për pranueshmërinë e lëndës.

4. Më 26 gusht Paneli morri përgjigjen e UNMIK-ut.

5. Më 2 shtator 2009, Paneli ia përcolli përgjigjen e UNMIK-ut ankueses, duke ftuar atë të parashtron komente të tjera, nëse ka dëshirë. Ankuesja iu përgjigj Panelit më 15 shtator 2009.

6. Më 9 shtator 2010, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme. Më 16 shtator 2010, Paneli ia dërgoi vendimin e vet PSSP-së, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e ankesës.

7. Më 7 tetor 2010, PSSP-ja dha komentet e UNMIK-ut.

8. Më 5 nëntor 2010, Paneli kërkoi nga PSSP-ja të parashtrojë dosje lidhur me hetimet penale dhe të mjekësisë ligjore lidhur me rastin. Më 30 nëntor 2010, PSSP-ja parashtroi dokumentacionin relevant.

9. Më 11 nëntor 2012, Paneli kërkoi nga UNMIK-u që të konfirmon nëse parashtrimi i dosjeve lidhur me rastin do të mund të konsiderohej si përfundimtar. UNMIK-u dorëzoi dokumente shtesë më 30 nëntor 2012.

II. FAKTET

A. Historik i përgjithshëm[2]

10. Ngjarjet në fjalë kanë ndodhur në territorin e Kosovës pas themelimit të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në qershor të vitit 1999.

11. Konflikti i armatosur gjatë viteve 1998 dhe 1999 mes forcave serbe në njërën anë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) e grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës, nga ana tjetër, është mirë i dokumentuar. Pas dështimit të përpjekjeve ndërkombëtare për ta zgjidhur konfliktin, më 23 mars 1999, Sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior ("NATO") shpalli fillimin e sulmeve ajrore kundër RFJ-së. Sulmet ajrore filluan më 24 mars 1999 dhe përfunduan më 8 qershor 1999, kur RFJ u pajtua që t'i tërheq forcat e saj nga Kosova. Më 9 qershor 1999, Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (KFOR), RFJ dhe Republika e Serbisë

---

[1] Lista e shkurtesave në tekst mund të gjendet në shtojcën e bashkëngjitur.

[2] Referencat, në të cilat është bazuar Paneli në përpilimin e këtij historiku të përgjithshëm përfshijnë: raportet tremujore të Sekretarit të Përgjithshëm për Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë; raportet vjetore të Policisë së UNMIK-ut (2000, 2001); të Qendrës për të drejtën humanitare, "Kidnapimet dhe zhdukjet e joshqiptarëve në Kosovë" (2001); të Qendrës për të drejtën humanitare, "Kosovo Memory Book" (htpp://www.kosovomemorybook.org); të Zyrës së UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore "Raport i aktiviteteve 2002-2004"; të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, *Behrami dhe Behrami kundër Francës* dhe *Saramati kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë*, nr. 71412/01 dhe 78166/01, vendim i datës 2 maj 2007; të Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, "The Situation in Kosovo: a Stock Taking" (2010); të të dhënave të publikuara nga Komisionari i lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, (mund të gjendet në www.unhchr.org) dhe të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (mund të gjendet në http://familylinks.icrc.org/kosovo/en)

nënshkruan "Marrëveshjen ushtarako-teknike", përmes së cilës ata u pajtuan për tërheqjen e RFJ-së nga Kosova dhe për praninë e një force ndërkombëtare të sigurisë pas nxjerrjes së një rezolute përkatëse të Këshillit të sigurimit të OKB-së.

12. Më 10 qershor 1999, Këshillit i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244 (1999). Duke vepruar sipas kapitullit VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara vendosi për dërgimin e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe të asaj civile - KFOR-it, përkatësisht UNMIK-ut, në territorin e Kosovës. Në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, OKB-ja ka pasur kompetenca të plota legjislative dhe ekzekutive për një periudhë të përkohshme të administrimit të Kosovës, duke përfshirë administrimin e drejtësisë. KFOR-i ka pasur për detyrë të krijojë "mjedis të sigurt, ku refugjatët dhe personat e zhvendosur do të mund të ktheheshin në shtëpi në mënyrë të sigurt", duke siguruar përkohësisht "rendin dhe sigurinë publike", derisa prania ndërkombëtare civile do të mund të merrte përgjegjësinë për këtë detyrë. UNMIK-u përbëhej nga katër komponentë apo shtylla kryesore, të udhëhequra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (administrata civile), Komisionari i lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (ndihmesa humanitare, e cila përfundoi në qershor të vitit 2000), OSBE-ja (ndërtimi i institucioneve) dhe BE-ja (rindërtim dhe zhvillim ekonomik). Çdo shtyllë ka qenë nën autoritetin e PSSP-së. Përmes Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, UNMIK-u morri mandatin që të "avancojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut" në Kosovë në përputhje me standardet ndërkombëtarisht të njohura të të drejtave të njeriut.

13. Vlerësimet lidhur me efektin e konfliktit të armatosur në zhvendosjen e popullatës së shqiptarëve të Kosovës shkojnë përafërsisht prej 800,000 deri në 1.45 milion njerëz. Pas miratimit të Rezolutës 1244 (1999), shumica e shqiptarëve të Kosovës që kishin ikur apo ishin dëbuar me dhunë nga shtëpitë e tyre nga forcat serbe gjatë konfliktit të armatosur, u kthyen në Kosovë.

14. Në ndërkohë, pjesëtarët e komunitetit joshqiptar – kryesisht, serbë, romë dhe myslimanë sllavë – si dhe shqiptarë të Kosovës që dyshoheshin për bashkëpunim me autoritetet serbe, u bën shënjestër e sulmeve të shumta nga grupet e armatosura të shqiptarëve të Kosovës. Vlerësimet e tanishme lidhur me numrin e serbëve të zhvendosur të Kosovës kapin shifrat prej 200,000 deri në 210,000. Derisa shumica e serbëve të Kosovës dhe joshqiptarëve të tjerë ikën për në Serbi dhe në vendet fqinje, ata që mbetën u bën viktimë e vrasjeve sistematike, kidnapimeve, ndaljeve arbitrare, dhunës seksuale e gjinore, rrahjeve dhe ngacmimeve.

15. Edhe pse shifrat kontestohen, vlerësohet se më shumë se 15000 vdekje apo zhdukje kanë ndodhur gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë dhe menjëherë pas tij (1998-2000). Më shumë se 3000 shqiptarë etnikë dhe rreth 800 serbë, romë dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera pakicë u zhdukën gjatë kësaj periudhe. Më shumë se gjysma e personave të zhdukur janë gjetur, dhe mbetjet e tyre mortore janë identifikuar deri në fund të vitit 2010, ndërsa sipas gjendjes në tetor të vitit 2012, ende gjenden 1766 persona në listën e personave të zhdukur të KNKK-së.

16. Duke filluar nga qershori i vitit 1999, në kuadër të përpjekjeve për rikthimin e rendit dhe ligjit në Kosovë në kuadër të kornizës për sundimin e ligjit, PSSP-ja kërkoi nga shtetet anëtare të OKB-së që të përkrahin angazhimin në kuadër të komponentit civil të UNMIK-ut të 4,718 zyrtarëve ndërkombëtarë policorë. Policia e UNMIK-ut morri detyrën e këshillimit të KFOR-it për çështjet policore derisa ata vet nuk i plotësuan numrat e mjaftueshëm për marrjen e përgjegjësive të plota në fushën e zbatimit të ligjit

dhe për të punuar drejt zhvillimit të shërbimit policor të Kosovës. Deri në shtator të vitit 1999, përafërsisht 1100 zyrtarë ndërkombëtarë policorë kishin ardhur në UNMIK.

17. Deri në dhjetor të vitit 2000, sistemimi i Policisë së UNMIK-ut pothuajse kishte përfunduar, me rreth 4400 zyrtarë policorë nga 53 vende të ndryshme, kështu që UNMIK-u kishte marrë parësinë rreth përgjegjësive për zbatimin e ligjit në të gjitha regjionet e Kosovës, përveç në Mitrovicë. Sipas Raportit vjetor të vitit 2000 të Policisë së UNMIK-ut, në periudhën mes qershorit 1999 dhe dhjetorit 2000 atyre u janë raportuar 351 kidnapime, 675 vrasje dhe 115 dhunime.

18. Për shkak të kolapsit të administrimit të drejtësisë në Kosovë, në qershor të vitit 1999 UNMIK-u themelojë një sistem emergjent të drejtësisë. Ky sistem ka qenë i përbërë prej një numri të kufizuar i gjyqtarëve dhe prokurorëve vendorë dhe ishte funksional deri në kohën e funksionalizimit të sistemit të rregullt të drejtësisë në janar të vitit 2000. Në shkurt të vitit 2000, UNMIK-u autorizoi emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, fillimisht në regjionin e Mitrovicës dhe më vonë në mbarë Kosovën, me qëllim të fuqizimit të sistemit vendor të drejtësisë dhe të garantimit të paanshmërisë së tij. Kështu, në tetor të vitit 2002, sistemi vendor i drejtësisë kishte 341 gjyqtarë dhe prokurorë vendorë dhe 24 ndërkombëtarë. Në janar të vitit 2003, Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, në raportimin e tij para Këshillit të Sigurimit lidhur me zbatimin e Rezolutës 1244 (1999) përkufizoi sistemin policor dhe të drejtësisë në Kosovë në atë moment si “mirëfunksionues” dhe “të qëndrueshëm”.

19. Në korrik të vitit 1999, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i raportoi Këshillit të Sigurimit se UNMIK-u tanimë ka shqyrtuar çështjen e personave të zhdukur si një shqetësim veçanërisht akut i të drejtave të njeriut në Kosovë. Në nëntor të vitit 1999, Njësia për Persona të Zhdukur (NjPZh) është themeluar në kuadër të Policisë së UNMIK-ut, e cila kishte mandatin për të hetuar vendndodhjen e mundshme të personave të zhdukur dhe/apo vendvarrimet e tyre. NjPZh-ja, së bashku me Njësinë Qendrore për Hetime Penale (NjQHP) të Policisë së UNMIK-ut, si dhe më vonë, me Njësinë enkas të formuar për Hetimin e Krimeve të Luftës (NjHKL) kanë qenë përgjegjëse për aspektet penale të rasteve të personave të zhdukur në Kosovë. Në maj të vitit 2000 u themelua Komisioni për Gjetjen dhe Identifikimin e Viktimave (KGjIV), i udhëhequr nga UNMIK-u me qëllim të gjetjes, identifikimit dhe dorëzimit të mbetjeve mortore. Që nga qershori i vitit 2002, Zyra e sapothemeluar për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (ZPZhML) në Departamentin e Drejtësisë (DD) të UNMIK-ut u bë i vetmi i autoritet me kompetenca të përcaktimit të vendndodhjes së personave të zhdukur, të identifikimit të mbetjeve mortore dhe të kthimit të tyre familjarëve të të zhdukurve. Që nga viti 2001, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) mes UNMIK-ut dhe Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (KNPZh), me seli në Sarajevë, dhe në bazë të një marrëveshjeje shtesë të vitit 2003, identifikimi i mbetjeve mortore është bërë nga ZPZhML-ja përmes testimit të ADN-së.

20. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi, dhe Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së kryetarit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), ku mirëpritej angazhimi i vazhdueshëm i Bashkimit Evropian në Kosovë.

21. Më datën e njëjtë, UNMIK-u dhe EULEX-i nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi (MM) rreth modaliteteve dhe të drejtave e obligimeve përkatëse që dilnin nga bartja prej UNMIK-ut tek EULEX-i e rasteve dhe të dosjeve përkatëse lidhur me hetimet, ndjekjet penale ne vazhdim e sipër, si dhe aktivitetet e tjera të ndërmarra nga prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut. Pak kohë më pas, marrëveshje të ngjashme janë nënshkruar përkitazi me dosjet e trajtuara nga gjyqtarët ndërkombëtarë dhe Policia e UNMIK-ut. Të gjitha marrëveshjet me EULEX-in parashihnin që UNMIK-u t'i jep qasje në dokumente lidhur me veprimet e ndërmarra nga autoritet e UNMIK-ut. Mes datës 9 dhjetor 2008 dhe 30 mars 2009, të gjitha dosjet e lëndëve penale të DD të UNMIK-ut dhe të Policisë së UNMIK-ut i janë dorëzuar EULEX-it.

B. Rrethanat lidhur me kidnapimin e z. Ah.C. dhe z. An.C.

22. Ankuesja znj. S.C., është bashkëshortja e Ah.C. dhe nëna e An.C.

23. Sipas ankueses, më 18 korrik 1999, Ah.C. dhe An.C. ishin në vendin e tyre të punës në Prizren, së bashku me një anëtar tjetër të familjes, kur tre pjesëtarë të uniformuar të UÇK-së erdhën dhe i njoftuan se komandanti i UÇK-së kishte urdhëruar kryerjen e disa punëve. Aty rreth orës 11:30, Ah.C. dhe An.C. i mblodhën veglat dhe e përcollën xhipin e UÇK-së me veturën e tyre në drejtim të Gjakovës. Anëtari tjetër i familjes mbeti në vendin e punës, ndërsa pjesëtarët e UÇK-së e njoftuan se Ah.C. dhe An.C. do të ktheheshin brenda gjysmë ore.

24. Kur Ah.C. dhe An.C. nuk u kthyen deri në kohën kur biznesi duhej mbyllur për atë ditë, pjesëtari i mbetur i familjes u kthye në shtëpi dhe njoftoi ankuesen për atë që kishte ndodhur. Kur ata nuk u kthyen edhe mëngjesin e ardhshëm, ankuesja dhe anëtari tjetër i familjes shkuan në shtabin e UÇK-së dhe në UNMIK për t'i kërkuar, por pa sukses.

25. Pas kësaj, ankuesja ia raportoi zhdukjet KFOR-it, UNMIK-ut dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK). Më 13 dhjetor 1999, ankuesja gjithashtu ia raportoi zhdukjet edhe Zyrës së OSBE-së në Prizren.

26. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2005, ankuesja ka parashtruar padi penale kundër kryerësve të panjohur para prokurorit ndërkombëtar të Zyrës së Prokurorit Publik të Qarkut (ZPPQ) në Prizren përkitazi me zhdukjen e anëtarëve të saj të familjes.

27. Ankuesja deklaron se nuk është në dijeni për hetimet e bëra pas raportimit të saj. Ajo thotë se UÇK-ja ia ka kërcënuar familjen, duke kërkuar që të mos kërkojnë më për Ah.C. dhe An.C, se përndryshe edhe ata do të zhduken.

28. Ankuesja deklaron se në vitin 2003 është njoftuar se bashkëshorti dhe djali i saj ishin gjetur të vdekur. Në vitin 2003 ose 2004 ajo vendosi të shpërngulet nga Kosova për shkak të kërcënimeve ndaj saj dhe familjes.

C. Hetimet

29. Lidhur me rastin në fjalë, Paneli ka pranuar dokumentet e hetimit nga UNMIK-u, të cilat më parë i ka pasur ZPZhML e UNMIK-ut dhe Policia e UNMIIK-ut (NjPZh dhe NjQPP).

30. Lidhur me paraqitjen e informatave nga dosjet, Paneli përkujton se UNMIK-u ia ka dhenë dosjet e hetimit Panelit nën zotimin e besueshmërisë. Në këtë aspekt, Paneli duhet të qartëson se edhe pse vlerësimi i tij përkitazi me rastin në fjalë rrjedh nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit në dispozicion, janë paraqitur vetëm informata të caktuara. Rrjedhimisht, në paragrafët vijues është dhënë përmbledhja e hapave hetimorë, të ndërmarrë nga autoritetet e hetuesisë.

31. Sipas ankueses, kidnapimi i Ah.C. dhe An.C menjëherë i është raportuar KFOR-it, KNKK-së, UNMIK-ut dhe OSBE-së.

32. Më 29 maj 2000, KNKK-ja ka lëshuar kërkesë për gjurmim lidhur me zhdukjen e Ah.C. dhe An.C..

33. Më 2 gusht të vitit 2000, Zyra e OSBE-së në Prizren ia dërgoi një komunikatë Zyrës së OSBE-së në Prishtinë, përmes së cilës kërkonte informata nga Policia e UNMIK-ut lidhur me gjendjen e procesit hetimor për zhdukjen e anëtarëve të familjes së ankueses. Sipas kësaj shkrese, lënda ishte bartur tek NjQHK e Policisë së UNMIK-ut në Prishtinë. Ankuesi kishte kërkuar informatë nga Kryqi i Kuq në Prizren, njëkohësisht duke deklaruar se nuk kishte marrë ndonjë informatë kthyese nga autoritetet.

34. Më pastaj OSBE-ja në Prishtinë ishte njoftuar se NjPZh e Policisë së UNMIK-ut kishte hapur dosjen për këtë lëndë, por se nuk ka qenë në gjendje të merr informata shtesë për rastin. Nga dokumentet e analizuara nga Paneli shihet numri i parë i dosjes në vitin 2000 dallonte nga ai i vitit 2001.

35. Më 10 gusht 2000, mbetjet mortore të dy kufomave të paidentifikuara janë gjetur nga hetuesit e Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi (TNPJ) në një varrezë afër varrezave të Prizrenit. Në një shkresë të hetuesve thuhej se kufomat ishin "në interes" të TNPJ-së. Sipas raporteve të datës 31 gusht 2000, TNPJ ka bërë një autopsi të dy kufomave më 24 gusht 2000. Në bazë të autopsisë është nxjerrë përfundimi se dy viktima të paidentifikuara meshkuj kishin vdekur si rezultat i plagëve të shumta me armë zjarri.

36. Më 29 janar 2002, KNKK-ja ka plotësuar formularët ante-mortem për identifikimin e viktimave lidhur me Ah.C. dhe An.C., të cilat i janë dërguar UNMIK-ut.

37. Më 26 dhjetor 2002, Njësia Regjionale e Hetimeve (NjRH) në Prizren ia dërgoi MPU-së në Prishtinë listën e rasteve të kidnapimit, të cilat raportohej se janë nën hetime, duke përfshirë edhe rastet e Ah.C. dhe An.C. Në shkresë gjithashtu gjendet edhe kërkesa për MPU lidhur me këmbimin e dosjeve të informatave që ata mund t'i kishin lidhur me rastet.

38. Në bazë të raporteve të datës 27 janar dhe 30 janar 2003, ZPZhML krahasoi mostrat e ADN-së nga kufomat e gjetura më 10 gusht 2000 me mostrat e ADN-së së anëtareve të familjes së An.C.-së. Në bazë të këtyre raporteve u nxor përfundimi se këto mostra përputheshin.

39. Më 18 shkurt 2003, në bazë të rezultateve të analizës së ADN-së dhe pas krahasimeve të informatave ante-mortem dhe post-mortem, ZPZhML e UNMIK-ut lëshoi konfirmimin e certifikatave të identitetit për Ah.C. dhe An.C..

40. Përmes letrës së datës 3 mars 2003, NjPZh e UNMIK-ut ka urdhëruar zhvarrimin në dy varreza të paidentifikuara nga varrezat e Suharekës, si dhe bartjen e kufomave në varrezat e Dragodanit në Prishtinë.

41. Më 6 mars 2003, z. M. C., i cili është djali i Ah.C dhe vëllai i An.C., pranoi kufomat e babait dhe vëllait të tij. z. M. C. kërkoi nga hetuesit që atij t'ia lënë përgjegjësinë e njoftimit të ankueses për vdekjen e Ah.C. dhe An.C., duke thënë se ankuesja kohëve të fundit kishte pasur një sulm në zemër.

42. Ankuesja thotë se në vitin 2003 është njoftuar për vdekjen e bashkëshortit dhe djalit të saj.

43. Në një datë të paspecifikuar para marsit të vitit 2005, autoritetet e Serbisë kanë parashtruar raport penal kundër kryerësve të panjohur në emër të ankueses tek prokurori ndërkombëtar i ZPPQ të Prizrenit. Në këtë raport, ankuesja deklaroi se ditën e njëjtë zhdukja i është raportuar KFOR-it, i cili me siguri ka bërë shënim zyrtar lidhur me këtë. Ankuesja gjithashtu kërkoi që pretendimet e saj të verifikohen dhe dëshmitarët e mundshëm të intervistohen. Megjithatë, nuk ka indikacion se dosja është shqyrtuar ndonjëherë apo se është ndërmarrë ndonjë veprim nga Zyra e prokurorit publik.

44. Më 13 mars 2005, NjHR e Prizrenit ia dorëzoi për shqyrtim NjHKL listën e rasteve të vrasjeve dhe kidnapimeve. Në këtë listë ishin edhe rastet e Ah.C. dhe An.C., ku nuk kishte informatë për çfarëdo veprimi të ndërmarrë kohëve të fundit.

45. Më 9 prill 2005, rasti lidhur me zhdukjen dhe vrasjen e Ah.C. dhe An.C.'s është regjistruar nga NjHKL. Në raportin e rasteve, ky rast figuron si joaktiv dhe ceket se Ah.C. dhe An.C. ishin ende të zhdukur.

46. Më 20 tetor 2007, NjHKL e UNMIK-ut ka shqyrtuar rastin. Në raportin e analizës së rastit shihet se deri atëherë nuk ishte marrë ndonjë deklaratë nga dëshmitarët dhe prapë cekej se Ah.C. dhe An.C. ishin ende të zhdukur. Hetuesi shqyrtues deklaroi se nuk është vërejtur ndonjë dëshmi, duke rekomanduar që rasti të mbyllej deri në marrjen e ndonjë dëshmie.

47. Një zyrtar tjetër i NjHKL ka shqyrtuar rastin më 27 dhjetor 2007. Prapë, Ah.C. dhe An.C. janë raportuar si të zhdukur. Hetuesi rekomandoi që rasti të mbetet joaktiv në pritje të informatave të reja.

III. ANKESA

48. Ankuesja ankohet për dështimin e pretenduar të UNMIK-ut që të hetojë në mënyrë të duhur kidnapimin dhe vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të saj. Në këtë aspekt, Paneli konsideron se ajo thirret në shkeljen e obligimit procedural të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj).

49. Ankuesja gjithashtu ankohet për dhimbje dhe vuajtje shpirtërore, e cila pretendohet t'i jetë shkaktuar asaj dhe familjes së saj nga kjo gjendje. Në këtë aspekt, Paneli konsideron se ankuesja mbështetet në nenin 3 të KEDNj-së.

IV. LIGJI

A. Fushëveprimi i shqyrtimit të Panelit

50. Në përcaktimin nëse konsideron se ka pasur shkelje të nenit 2 (obligimit procedural) dhe të nenit 3 të KEDNj-së, Paneli merr parasysh praktikën ekzistuese gjyqësore, më konkretisht, të asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Megjithatë, Paneli është po ashtu në dijeni se ankesat e parashtruara në Panel kanë dallime mjaft domethënëse nga ato që parashtrohen në Gjykatë. E para, pala e paditur nuk është shtet, por një administratë e përkohshme ndërkombëtare, e cila ka mandatin e ushtrimit të përgjegjësive të përkohshme në Kosovë. Ndaj UNMIK-ut nuk ngrihet ndonjë dyshim lidhur me obligimet substanciale, të parapara në nenin 2 të KEDNj-së. E dyta, siç ndodh edhe një një numër të kufizuar lëndësh para Gjykatës Evropiane, ata që dyshohen se janë përgjegjës për vrasjet dhe/apo kidnapimet e pretenduara në të gjitha rastet para Panelit janë aktorë joshterërorë, kryesisht, por jo plotësisht, të lidhur me konfliktin e armatosur. Këta faktorë Paneli duhet t'i merr parasysh me rastin e vlerësimit për herë të parë të obligimeve pozitive procedurale të një organizate ndërqeveritare përkitazi me veprat e kryera nga palët e treta në territorin, ndaj të cilit ka kontroll të përkohshëm legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

51. Para se t'i kthehemi shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli ka nevojë të qartësojë fushëveprimin e shqyrtimit të tij.

52. Paneli thekson se pas miratimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1 më 25 korrik 1999, UNMIK-u ka marrë përsipër obligimin që të zbatojë standardet ndërkombëtarisht të njohura të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve të tij. Kjo përgjegjësi është përshkruar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, të datës 12 dhjetor 1999, përmes së cilës UNMIK-u ka marrë obligimet në bazë të dokumenteve vijuese për të drejtat e njeriut: Deklarata Universale për të Drejta të Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe protokollet e saj, Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike, Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Femrave, Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Dënimeve të tjera të Vrazhda, Çnjerëzore ose Poshtëruese; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës.

53. Paneli gjithashtu nënvizon se neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, i datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut parasheh që Paneli "shqyrton ankesat e cilitdo personi apo grupi personash që pretendojnë se kanë qenë viktima të shkeljes së të drejtave të tyre nga UNMIK-u". Nga kjo del se vetëm veprat apo lëshimet që i atribuohen UNMIK-ut hyjnë brenda juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Në këtë aspekt, duhet të theksohet, siç është cekur më lartë, se që nga data 9 dhjetor 2008, UNMIK-u më nuk ushtron autoritet ekzekutiv ndaj gjyqësorit të Kosovës dhe ndaj mekanizmave për zbatimin e ligjit. Kështu që UNMIK-u nuk ka përgjegjësi për çfarëdo shkeljeje të të drejtave të njeriut që pretendohet të jetë kryer nga ato organe. Për aq sa ankuesja ankohet për veprat e ndodhura pas kësaj date, ato mbesin jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit.

54. Po kështu, Paneli thekson se sa i përket juridiksionit të tij *ratione materiae*, ashtu siç parashihet në nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se mund të shqyrtojë vetëm veprat apo lëshimet, ndaj të cilave është parashtruar ankesa përkitazi me përputhshmërinë e tyre me dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e

njeriut, të cekura më lartë (§ 53). Lidhur me rastin në fjalë të vrasjeve dhe kidnapimeve në rrethana kërcënuese për jetë, nuk është roli i Panelit që të zëvendësojë autoritetet kompetente për hetimin e rastit. Detyra e tij është e kufizuar në shqyrtimin e efekshmërisë së hetimeve penale për ato vrasje dhe zhdukje lidhur me obligimet procedurale që rrjedhin nga neni 2 i KEDNj-së.

55. Paneli më tej thekson se neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 parasheh që Paneli ka juridiksion ndaj ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut "të cilat kanë ndodhur jo më herët se më datën 23 prill 2005 apo që dalin nga faktet, që kanë ndodhur para kësaj date në rastet kur këto fakte ndikojnë në shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Nga kjo rrjedh se ngjarjet që kanë ndodhur para datës 23 prill 2005 në përgjithësi mbesin jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit. Megjithatë, për aq sa këto ngjarje nxisin një gjendje të vazhdueshme, Paneli ka juridiksion të shqyrtojë ankesat lidhur me atë gjendje (shih Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj) (Dhoma e lartë), *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 16064/90 dhe të tjerët, aktgjykim i datës 18 shtator 2009, §§ 147-149; GjEDNj, *Qipro kundër Turqisë*, nr. 25781/94, aktgjykim i datës 10 maj 2011, § 136).

B. Shkelja e pretenduar e obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNj-së

Pranueshmëria

56. Përkitazi me shkeljen e pretenduar të nenit 2 të KEDNj-së, në komentet e tij për bazueshmëri, të datës 7 tetor 2010, PSSP-ja fillimisht ka vërejtje në atë se hetimi është ende në vazhdim e sipër. Për këtë arsye, Paneli duhet të shpall rastin si të papranueshëm për shkak të mosshterrjes së mjeteve juridike në dispozicion në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

57. Në këtë aspekt, Paneli nënvizon se PSSP-ja nuk ka cekur ndonjë mjet specifik juridik në dispozicion të ankueses lidhur me vet efektshmërinë e hetimit. Nga ana e tij, Paneli nuk sheh ekzistimin e një mjeti të tillë juridik. Fakti se rasti aktualisht është nën hetim nuk çon peshë në objektin e ankesës; efektshmëria e vet hetimit (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut (PKDNj), *D.P.*, lënda nr. 04/09, vendim i datës 6 gusht 2010).

58. Rrjedhimisht, vërejtja e PSSP-së hidhet poshtë dhe ankesa shpallet e pranueshme sipas nenit 2.

Bazueshmëria

1. Parashtresat e palëve

59. Ankuesja në thelb pretendon shkelje përkitazi me mungesën e hetimit të duhur për kidnapimin dhe vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të saj. Ankuesja gjithashtu deklaron se nuk ka qenë e njoftuar nëse është bërë ndonjë hetim dhe se cili ka qenë rezultati.

60. Ankuesja thotë se që nga zhdukja e bashkëshortit dhe djalit të saj, jeta e saj dhe e familjes së saj ka qenë e "mjerueshme" dhe "dëshpëruese". Ankuesja deklaron se ka përjetuar sulm në zemër dhe pasi që u njoftua se familjarët e saj ishin vrarë, ajo kishte rënë në komë për një kohë të caktuar. Ajo kërkon që të kompensohet për vuajtjet e saj.

61. Në komentet e tij të datës 7 tetor 2010, PSSP-ja thekson se pas pranim-dorëzimit në EULEX në dhjetor të vitit 2008, të gjitha dosjet hetimore të UNMIK-ut i janë dorëzuar EULEX-it (shih §§ 20-21 më lartë). Që nga ajo kohë UNMIK-u varet nga EULEX-i kur kemi të bëjmë me dhënien e informatave për çështje lidhur "me hetimet e policisë dhe të drejtësisë".

62. PSSP-ja deklaron se në këtë rast UNMIK-u ka marrë kopjet nga EULEX-i të "disa dokumenteve, të cilat i ka pasur ish-Zyra për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore", "disa dokumente që i janë dorëzuar Njësisë së EULEX-it kundër krimeve të luftës në fund të vitit 2008" dhe një informatë të fundit për rastin të dhënë nga EULEX-i. PSSP-ja deklaron se "Informata në të cilën mbështetet UNMIK-u mund të mos jetë e plotë". Megjithatë, më 30 nëntor 2012 UNMIK-u ka ofruar dokumente shtesë.

63. Në komentet e tij për bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja pajtohet se në bazë të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, UNMIK-u ka qenë përgjegjës për sigurinë e personave që jetojnë në Kosovë. Përgjegjësia policore e UNMIK-ut ka përfshirë që "UNMIK-u ka pasur mandatin të mbrojë njerëzit në Kosovë kundër aktiviteteve të krimit dhe të zbatojë hetime të efektshme të krimeve". Rrjedhimisht, PSSP-ja pajtohet se UNMIK-u ka pasur obligim të zbatojë hetim të efektshëm për zhdukjen dhe vrasjen e Ah.C. dhe An.C., ashtu siç parashihet në nenin 2 të KEDNj-së.

Megjithatë, PSSP-ja jep vërejtje, duke deklaruar se forma dhe shkalla e hetimit të nevojshëm për të arritur qëllimin e nenit 2 të KEDNj-së varet nga rrethanat e rastit specifik. Në këtë drejtim, PSSP-ja përkujton aktgjykimin e datës 18 maj 2000 të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut për rastin *Velikova kundër Bullgarisë,* ku në paragrafin 80 thuhet:

> " [..] natyra dhe shkalla e shqyrtimit, i cili plotëson pragun minimal të efektshmërisë së hetimeve varet nga rrethanat e rastit specifik. Efektshmëria duhet të vlerësohet në bazë të të gjitha fakteve relevante dhe duke marrë parasysh realitetin praktik të punës hetimore. Nuk është e mundur të zvogëlohet llojllojshmëria e punës hetimore thjesht në një listë aktivitetesh hetuese apo të kritereve të tjera të thjeshtësuara."

64. PSSP-ja është i mendimit dhe pavarësisht përgjegjësisë së UNMIK-ut për punët policore, se "rrethanat e veçanta" që kanë ndikuar në aftësinë e UNMIK-ut për të hetuar krimet, veçanërisht në fazën fillestare të misionit të tij, po ashtu duhet të merren parasysh.

65. Në veçanti, duhet të merret parasysh se gjatë fazës fillestare të misionit të tij, UNMIK-u nuk ka mundur të mbështetet në aparatin funksional të policisë apo në personel të specializuar që kanë qenë në gjendje të hetojnë të gjitha krimet e kryera. PSSP-ja deklaron se ardhja e forcës ndërkombëtare të policisë së UNMIK-ut u realizua në mënyrë shumë të ngadalshme. Deri në mesin e shtatorit 1999, UNMIK-u kishte përafërsisht 1100 policë ndërkombëtarë në teren, ndërsa struktura e duhur e policisë, duke përfshirë sistemin e njësive për hetime penale në mbarë Kosovën ishte themeluar vetëm gjatë muajve pasues. Në ndërkohë, nga policia është kërkuar që të zbatojë detyra të shumëfishta, duke filluar nga hetimi i krimeve, ruajtja e rendit dhe ligjit, rregullimi i trafikut dhe detyrat e tjera.

66. PSSP-ja thotë se një rrethanë tjetër që duhet të merret parasysh në vlerësimin e efektshmërisë së hetimeve për rastin në fjalë është fakti se kidnapimi i bashkëshortit dhe djalit të ankueses ka ndodhur në kohën kur shkalla e krimit në Kosovë ishte "më e larta", gjegjësisht në qershor të vitit 1999 pas bombardimeve të NATO-s. Sipas PSSP-së, gjatë viteve 1999 dhe 2000 UNMIK ka pranuar me qindra raporte për zhdukjet dhe vrasjet e serbëve të Kosovës, të cilat kanë qenë veçanërisht sfiduese për t'u hetuar për shkak të resurseve të kufizuara, si dhe mungesës së pistave hetimore, siç ndodhi edhe me rastin në fjalë.

67. Pasi që OKB-ja nuk ka forcë të përhershme policore të vetën dhe duhet të mbështetet në forcat e kontribuara nga shtetet anëtare, UNMIK-u nuk ka pasur kontroll në rekrutimin e policëve ndërkombëtarë, të cilët shpesh nuk kanë pasur përvojë të mjaftueshme për hetimin e krimeve të aspektit ndëretnik në kontekstin e paskonfliktit të armatosur. Po ashtu, rotacioni i policëve, të cilët caktoheshin vetëm për periudha gjashtëmujore deri në një apo dy vjeçare ka penguar vazhdimësinë e hetimeve.

68. Për këto arsye, PSSP-ja argumenton se "standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut lidhur me hetimin e efektshëm nuk mund të jenë të njëjta për UNMIK-un dhe shtetin që ka një mekanizëm policor funksional dhe të organizuar mirë, si dhe me policë që mund t'i rekrutojë, përzgjedhë dhe trajnojë".

69. Për më tepër, PSSP-ja është i mendimit se Policia e UNMIK-ut ka bërë hetim të efektshëm lidhur me zhdukjen e Ah.C. dhe An.C.. Megjithatë, "për shkak të informatave dhe pistave minimale hetimore në dispozicion, nuk kanë mundur të arrihen rezultate konkrete".

2. Vlerësimi i Panelit

a) Parashtrimi i dosjeve relevante

70. PSSP-ja vëren se dosja e lëndës që i është parashtruar Panelit lidhur me hetimin e rastit të Ah.C. dhe An.C. mund të mos jetë e plotë.

71. Paneli thekson se në nenin 15 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 parashihet që Paneli mund të kërkojë dorëzimin nga UNMIK-u të cilitdo dokumenti dhe se PSSP-ja do të bashkëpunojë me Panelin, duke dhënë ndihmesën e nevojshme duke përfshirë, në veçanti, dhënien e dokumenteve dhe informatave relevante për ankesën. Në këtë drejtim Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe se konkluzionet do të nxjerrën nga sjellja e palës së paditur gjatë procedurës, duke përfshirë "nga mosdhënia e informatave në dispozicionin e tyre pa arsyetim të kënaqshëm" (shih GjEDNj, *Çelykbylek kundër Turqisë*, nr. 27693/95, aktgjykim i datës 31 maj 2005, § 56).

72. Paneli thekson se së paku tri herë nga UNMIK-u është kërkuar të parashtrojë dokumentacion relevant lidhur me rastin. Në përgjigje ndaj kërkesës së fundit të Panelit, më 30 nëntor 2012, UNMIK-u deklaroi se paraqitja e dosjes së rastit do të mund të konsiderohej si përfundimtare.

73. Paneli nënvizon se mbajtja e duhur e dosjeve hetimore për krimet, siç janë vrasjet dhe zhdukjet, duke filluar nga hapja e hetimeve e deri te dorëzimi i tyre, është thelbësore për vazhdimin e atyre hetimeve dhe se rrjedhimisht në vetvete do të mund të ngriste çështje sipas nenit 2. Paneli gjithashtu thekson se UNMIK-u nuk ka dhënë ndonjë

shpjegim për arsyen e mundësisë që dokumentacioni të mos jetë i plotë, e as lidhur me atë se cilat pjesë nuk janë të plota.

74. Vet Paneli nuk është në gjendje të verifikon plotësinë e dosjeve hetuese të pranuara. Kështu që Paneli do të vlerësojë bazueshmërinë e ankesës në bazë të dokumenteve që i janë dhënë në dispozicion (në këtë aspekt, shih GjEDNj, *Tsechoyev kundër Rusisë*, nr. 39358/05, aktgjykim i datës 15 mars 2011, § 146).

b) Parimet e përgjithshme lidhur me obligimin për të kryer hetim të efektshëm sipas nenit 2

75. Ankuesja deklaron se UNMIK-u nuk ka kryer hetim të efektshëm për zhdukjen dhe vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të saj.

76. Paneli me këtë rast thekson se obligimi pozitiv për të hetuar zhdukjet gjerësisht është i njohur në të drejtën ndërkombëtare për të drejta të njeriut së paku që nga rasti i Gjykatës Ndëramerikane për të Drejta të Njeriut (GjIDNj) *Velásquez Rodríguez* (shih GjIDNj, *Velásquez Rodríguez kundër Hondurasit*, aktgjykim i datës 29 korrik 1988). Obligimi pozitiv gjithashtu është cekur edhe nga Komisioni i OKB-së për të drejta të njeriut, ku thuhet se ky obligim buron nga neni 6 (e drejta për jetë), neni 7 (ndalimi i trajtimit të vrazhdë dhe çnjerëzor) dhe nenit 9 (e drejta për liri dhe siguri të personit) lidhur me nenet 2 (3) (e drejta për mjet të efektshëm juridik) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike (KNDCP) (shih Komisioni për të Drejta të Njeriut (KDNj), Koment i përgjithshëm nr. 6, i datës 30 prill, § 4; KDNj, Koment i përgjithshëm nr. 31, i datës 26 maj 2004, CCPR/C/21/Rev.1/Add. 13) §§ 8 dhe 18; shih gjithashtu, në mes të tjerash, KDNj, *Mohamed El Awani, kundër Xhamahirisë Arabe të Libisë*, komunikimi nr. 1295/2004, pikëpamjet e datës 11 korrik 2007, CCPR/C/90/D/1295/2004). Obligimi për hetimin e zhdukjeve dhe vrasjeve gjithashtu vërtetohet përmes Deklaratës së OKB-së për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet e dhunshme (1/Res/47/133, e datës 18 dhjetor 1992), si dhe shpjegohet më në hollësi në udhëzimet e OKB-së, siç është Doracaku i OKB-së për parandalimin dhe hetimin e efektshëm të ekzekutimeve të jashtëligjshme dhe arbitrare (1991) dhe në "Udhëzimet për zbatimin e hetimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara lidhur me pretendimet për masakra" (1995). Rëndësia e këtij obligimi vërtetohet edhe përmes miratimit të Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukjet e Dhunshme të vitit 2006, e cila hyri në fuqi më 23 dhjetor 2010.

77. Për të trajtuar pretendimet e ankueses, Paneli i referohet praktikës së konsoliduar gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut lidhur me obligimin procedural, të paraparë sipas nenit 2 të KEDNj-së. Gjykata ka konstatuar se "Obligimi për mbrojtjen e të drejtës në jetë, i paraparë me nenin 2 të Konventës, lidhur me detyrën e përgjithshme të shtetit sipas nenit 1 të Konventës për t'ia "siguruar çdokujt brenda juridiksionit të tij të drejtat dhe liritë e përkufizuara në Konventë", në mënyrë të nënkuptuar kërkon që duhet të ketë një lloj të hetimi të efektshëm zyrtar me rastin e vrasjes së individit (shih, përshtashmërisht, GjEDNj, *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i datës 27 shtator 1995, § 161, vëllimi A nr. 324; dhe *Kaya kudër Turqisë*, aktgjykim i datës 19 shkurt 1998, § 105, raportet 1998-I; shih gjithashtu GjEDNj, *Jasinskis kundër Letonisë*, nr. 45744/08, aktgjykim i datës 21 dhjetor 2010, § 71). Detyra për realizimin e hetimit të tillë vlen për të gjitha rastet e vrasjeve dhe vdekjeve të tjera të dyshimta, qofshin kryerësit persona privatë, agjentë shtetërorë ose persona të panjohur (shih GjEDNj, *Kolevi kundër Bullgarisë*, nr. 1108/02, aktgjykim i datës 5 nëntor 2009, § 191).

78. Gjykata Evropiane gjithashtu ka deklaruar se obligimi procedural për ofrimin e një lloji të hetimit të efektshëm zyrtar ekziston edhe kur individi zhduket në rrethana kërcënuese për jetë, dhe nuk kufizohet vetëm në rastet, ku duket se zhdukja është shkaktuar nga agjenti i shtetit (shih GjEDNj (Dhoma e lartë), *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar në § 55 më lartë, § 136).

79. Autoritetet duhet të veprojnë me iniciativë të vet në momentin kur janë njoftuar për çështjen, dhe nuk mund t'ia lënë këtë iniciativë të afërmit që ai të parashtrojë ankesën formale ose të merr përgjegjësinë e zhvillimit të çfarëdo procedure të hetimore (shih GjEDNj, *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 21689/93, aktgjykimi i datës 6 prill 2004, § 310, shih gjithashtu GjEDNJ, *Isayeva kundër Rusisë*, nr. 57950/00, aktgjykimi i datës 24 shkurt 2005, § 210).

80. Me rastin e caktimit të standardeve të hetimit të efektshëm, Gjykata ka deklaruar se "përveç të qenit i pavarur, i qasshëm për familjen e viktimës, i zbatuar me urgjencë dhe shpejtësi të arsyeshme, me element të mjaftueshëm të kontrollit publik të hetimeve dhe rezultateve të tyre, hetimi duhet gjithashtu të jetë i efektshëm në kuptimin që të çojë në përcaktimin e asaj nëse vdekja është shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe, nëse po, në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës (shih GjEDNj, *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lartë § 191; shih gjithashtu GjEDNj, *Palić kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, nr. 4704/04, aktgjykim i datës 15 shkurt 2011, § 63). Ky nuk është obligim i rezultateve, por i mjeteve. Autoritetet duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e mundshëm për të siguruar dëshmitë rreth incidentit, duke përfshirë në mes të tjerash, dëshmitë e dëshmitarëve okularë, dëshmitë mjekoligjore, dhe, aty ku parashihet, autopsinë, përmes së cilës jepet raport i plotë dhe i saktë për lëndimet dhe një analizë objektive e konstatimeve klinike, duke përfshirë edhe shkakun e vdekjes. Çfarëdo mangësie në procesin e hetimeve, e cila zvogëlon kapacitetin e tyre për përcaktimin e shkakut të vdekjes ose të personit a personave përgjegjës për të, do të rrezikojë mosplotësimin e këtij standardi (shih GjEDNj, *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar § 80 më lartë, § 312, dhe *Isayeva kundër Rusisë*, cituar § 81 më lartë, § 212).

81. Në veçanti, konkludimet e hetimeve duhet të bazohen në analizë të thuktë, objektive dhe të paanshme të të gjithë elementëve relevantë. Mosrespektimi i rrjedhës normale të hetimeve zvogëlon dukshëm mundësinë e përcaktimit të rrethanave të rastit dhe identitetin e personave përgjegjës (shih GjEDNj, *Kolevi kundër Bullgarisë*, cituar më lartë, § 201). Sido që të jetë, natyra dhe shkalla e kontrollit, i cili do të plotësonte pragun minimal të efektshmërisë së hetimeve varet nga rrethanat e çdo rasti veç e veç. Ato duhet të vlerësohen në bazë të të gjitha fakteve relevante dhe duke marrë parasysh realitetin praktik të punës hetimore (shih GjEDNj, *Velcea dhe Mazăre kundër Rumanisë*, nr. 64301/01, aktgjykimi i datës 1 dhjetor 2009, § 105).

82. Posaçërisht lidhur me personat që janë zhdukur dhe më vonë janë gjetur të vdekur, Gjykata ka deklaruar se procedurat për zhvarrosjen dhe identifikimin e mbetjeve mortore nuk shterin obligimin e paraparë sipas nenit 2 të KEDNj-së. Gjykata konsideron se "obligimi procedural që rrjedh nga zhdukja në përgjithësi mbetet për aq kohë sa vendndodhja dhe fati i personit nuk dihet dhe, rrjedhimisht, është i natyrës vazhduese" (GjEDNj, *Palić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, cituar § 81 më lartë, § 46; në kuptim të njëjtë GjEDNj (Dhoma e lartë), *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar § 55 më lartë, në § 148). Megjithatë, Gjykata gjithashtu thekson se ky obligim procedural "nuk përfundon madje edhe kur gjendet kufoma...kjo vetëm hedh dritë në

aspektin e fatit të personit të zhdukur, ndërsa obligimi për përcaktimin e zhdukjes dhe të vdekjes, si dhe të identifikimit e të ndjekjes penale të cilitdo kryerës të akteve të paligjshme lidhur me atë rast në përgjithësi mbetet" (GjEDNJ, *Palić kundër Bosnje Hercegovinës*, cituar § 81 më lartë, at § 46; në kuptim të njëjtë GjEDNj (Dhoma e lartë), *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lartë, në § 145). Derisa gjetja dhe identifikimi i mëpastajmë i mbetjeve mortore në vetvete mund të jenë të arritura të mëdha, obligimi procedural i paraparë në nenin 2 ende vazhdon të ekzistojë (shih GjEDNj, *Palić kundër Bosnje Hercegovinës*, cituar më lartë, në § 64).

83. Sa i përket kontrollit publik, Gjykata ka deklaruar më tej se duhet të ekziston element i mjaftueshëm i kontrollit publik të hetimit dhe të rezultateve të tij për të siguruar llogaridhënie si në praktikë, ashtu edhe në teori. Shkalla e kërkuar e kontrollit publik mund të ndryshojë prej rastit në rast. Megjithatë, në të gjitha rastet i afërmi i viktimës duhet të jetë i përfshirë në procedurë në masën e nevojshme për të ruajtur interesat legjitime të tij (shih *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar § 81 më lartë, §§ 311-314; *Isayeva kundër Rusisë*, cituar më lartë, §§ 211-214 dhe lëndët e cituara aty)." GjEDNj (Dhoma e lartë), *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 55721/07, aktgjykimi i datës 7 korrik 2011, § 167).

c) Zbatueshmëria e nenit 2 në kontekstin e Kosovës

84. Paneli është në dijeni se kidnapimi dhe vrasja e Ah.C. dhe An.C. ka ndodhur pak kohë pas ardhjes së UNMIK-ut në Kosovë menjëherë pas konfliktit të armatosur kur krimi, dhuna dhe pasiguria kanë qenë të përhapura gjithandej.

85. Nga ana e tij, PSSP-ja nuk e vë në pikëpyetje faktin se UNMIK-u ka pasur detyrë të hetojë rastin në fjalë në bazë të nenit 2 të KEDNJ-së. Megjithatë, sipas PSSP-së, rrethanat specifike të kontekstit të Kosovës dhe të ardhjes së UNMIK-ut në fazën e parë të misionit të tij duhet të merren parasysh me rastin e vlerësimit nëse ky hetim është në përputhje me nenin 2 të KEDNJ-së. Në thelb, PSSP-ja deklaron se nuk është mundur që të zbatohen standarde të njëjta për UNMIK-un, siç zbatohen për shtetin në një situatë normale.

86. Paneli konsideron se argumentet e PSSP-së ngrisin dy çështje kryesore: e para - a vazhdojnë të vlejnë standardet e nenit 2 në gjendje të konfliktit apo të dhunës së përgjithshme dhe e dyta - a do të konsiderohen ato standarde plotësisht të zbatueshme për UNMIK-un, posaçërisht gjatë fazës së parë të misionit të tij.

87. Lidhur me zbatueshmërinë e nenit 2 ndaj UNMIK-ut, Paneli përkujton se me miratimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1, të datës 25 korrik 1999, UNMIK-u ka marrë përsipër që gjatë ushtrimit të funksioneve të tij të respektojë standardet ndërkombëtarisht të njohura të të drejtave të njeriut. Kjo përgjegjësi është përshkruar në hollësi në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, të datës 12 dhjetor 1999, përmes së cilës UNMIK-u morri përgjegjësitë në bazë të disa instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe KEDNJ-në. Në këtë aspekt, Paneli tanimë ka konstatuar se është e vërtetë që karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e ndërlidhura duhet plotësisht të merren parasysh lidhur me një numër situatash, por në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të përdoren si arsyetim për zvogëlimin e nivelit të standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat kanë qenë të përfshira në mandatin e UNMIK-ut (shih PKDNj, *Millogoriq dhe të tjerët*, nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08, 69/08, mendimi i datës 24 mars 2011, § 44; *Berisha dhe të tjerët*, nr. 27/08 dhe,

mendimi i datës 23 shkurt 2011, § 25; *Llalliq dhe të tjerët*, nr. 09/08 dhe të tjerët, mendim i datës 9 qershor 2012, § 22).

88. Lidhur me zbatueshmërinë e nenit 2 për situatat e konfliktit apo të dhunës së përgjithësuar, Paneli përkujton se Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut ka përcaktuar zbatueshmërinë e nenit 2 për situatat e paskonfliktit, duke përfshirë edhe për vendet e ish-Jugosllavisë (shih, në mes të shembujve të tjerë, GjEDNj, ECtHR, *Paliq kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, cituar § 81 më lartë, dhe GjEDNj, *Jullariq kundër Kroacisë*, nr. 20106/06,aktgjykim i datës 20 janar 2011). Gjykata më tej ka konstatuar se obligimi procedural sipas nenit 2 vazhdon të vlejë "në kushte të vështira të sigurisë, duke përfshirë në kontekstin e konfliktit të armatosur" (shih GjEDNj (Dhoma e lartë), *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar § 84 më lartë § 164; shih gjithashtu GjEDNJ, *Güleç kundër Turqisë*, nr. 21593/93, aktgjykimi i datës 27 korrik 1998, § 81, Raporte të aktgjykimeve dhe vendimeve 1998 IV; GjEDNj, *Ergi kundër Turqisë*, nr. 23818/94, aktgjykimi i datës 28 korrik 1998, §§ 79 dhe 82, Raporte 1998 IV; GjEDNj, *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar § 80 më lartë, §§ 5-90 dhe 309-320 dhe 326-330; *Isayeva kundër Rusisë*, cituar § 80 më lartë, §§ 180 dhe 210; GjEDNj, *Kanlibaş kundër Turqisë*, nr. 32444/96, aktgjykim i datës8 dhjetor 2005, §§ 39-51).

89. Gjykata ka konstatuar se "në rast se vdekja [dhe zhdukjet] që do të hetohen në bazë të nenit 2 ndodhin në rrethana të dhunës së përgjithësuar, të konfliktit të armatosur apo të kryengritjes, hetuesit mund të ballafaqohen me pengesa dhe kufizimet konkrete që mund të nxisin përdorimin e masave më pak të efektshme të hetimit apo mund të shkaktojnë vonesën e hetimeve". (shih, GjEDNj (Dhoma e lartë), *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar § 84 më lartë në §164; GjEDNj, *Bazorkina kundër Rusisë*, nr. 69481/01, aktgjykimi i datës 27 korrik 2006, § 121). Pavarësisht kësaj, Gjykata ko konstatuar se "obligimi sipas nenit 2 për ruajtjen e jetës parasheh që, në kushte të vështira të sigurisë, të gjithë hapat e arsyeshëm duhet të ndërmerren për t'u siguruar në zbatimin e hetimit të efektshëm dhe të pavarur lidhur me shkeljet e pretenduara të së drejtës në jetë (shih, në mes të shumë shembujve të tjerë, *Kaya kundër Turqisë*, cituar në § 78 më lartë, §§ 86-92; *Ergi*, cituar në § 89 më lartë, §§ 82-85; *Tanrıkulu kundër Turqisë* (Dhoma e lartë), nr. 23763/94, aktgjykimi i datës 8 korrik 1999, §§ 101-110; *Khashiyev dhe Akayeva kundër Rusisë*, nr. 57942/00 dhe 57945/00, aktgjykim i datës 24 shkurt 2005, §§ 156-166; *Isayeva*, cituar më lartë, §§ 215-224; *Musayev dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 57941/00, 58699/00 dhe 60403/00, aktgjykim i datës 26 korrik 2007, §§ 158-165).

90. Ngjashëm me këtë, KDNj ka konstatuar që e drejta në jetë, duke përfshirë garancitë e saj procedurale, konsiderohet si e drejtë supreme, e cila nuk lejon derogim edhe në kohëra të emergjencave publike, të cilat kërcënojnë jetën e kombit (shih, KDNj, Koment i përgjithshëm nr. 6, cituar më lartë, § 1; KDNj, *Abubakar Amirov dhe Aïzan Amirova kundër Federatës së Rusisë*, komunikimi nr. 1447/2006, pikëpamjet e datës 2 prill 2009, § 11.2, CCPR/C/95/D/1447/2006). Më tej, KDNj ka deklaruar se zbatueshmëria e nenit 2 (3), 6 dhe 7 e KNDCP, me referencë specifike në obligimin e UNMIK-ut për realizimin e hetimit të duhur për zhdukjet dhe kidnapimet në Kosovë (shih KDNj, Vrojtimet përmbyllëse të Komisionit për të drejta të njeriut: Kosovë (Serbi), 14 gusht 2006, §§ 12-13, CCPR/C/UNK/CO/1).

91. Paneli i kupton vështirësitë, me të cilat është ballafaquar UNMIK-u gjatë fazë së parë pas ardhjes së tij. Megjithatë, Paneli thekson se rëndësia e duhur për çështjen e personave të zhdukur në Kosovë ka nënkuptuar që UNMIK-u është dashur të merr

parasysh si dimensionin humanitar, ashtu edhe atë të krimit të kësaj gjendjeje. Në veçanti, Paneli konsideron se rëndësia e hetimeve penale dhe vështirësitë në Kosovë, të cilat kanë kufizuar aftësitë e autoriteteve hetimore për kryerjen e këtyre hetimeve, siç është përshkruar nga PSSP-ja, e kanë bërë thelbësor aspektin që UNMIK-u që në fillim të krijojë mjedis të përshtatshëm për realizimin e hetimeve të mirëfillta. Këtu do të përfshihej edhe krijimi i një sistemi ku do të përfshiheshin elemente si caktimi i përgjegjësisë së përgjithshme për mbikëqyrjen dhe monitorimin e përparimit të hetimeve dhe procesin për pranim-dorëzimin e duhur të lëndëve mes zyrtarpve të njësive të Policisë së UNMIK-ut. Një sistem i tillë po ashtu do të duhet të merrte parasysh nevojat për mbrojtje të viktimave dhe dëshmitarëve (shih, *përshtatshmërisht*, GjEDNj, *R.R. dhe të tjerët kundër Hungarisë*, nr. 19400/11, aktgjykim i datës 4 dhjetor 2012, §§ 28-32). Duke kuptuar se ardhja dhe organizimi i policisë dhe i sistemit të drejtësisë ka ndihur gradualisht, Paneli konsideron se ky proces është përfunduar në vitin 2003, kur Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e ka përshkuar sistemin e policisë dhe të drejtësisë në Kosovë si "mirëfunksional" dhe të "qëndrueshëm" (shih § 18 më lartë).

92. Paneli më tej thekson se detyra e tij nuk është që të shqyrtojë praktikat relevante apo pengesat e pretenduara në realizmin e hetimeve të efektshme *in abstracto*, por vetëm zbatimin e tyre specifik në rrethana të caktuara të situatës, ndaj së cilës është parashtruar ankesa para tij. (shih GjEDNj, *Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 11209/84, 11234/84, 11266/84, 11386/85, aktgjykim i datës 29 nëntor 1988, § 53, vëllimi A nr. 145 B). Rrjedhimisht, Paneli pajtohet me PSSP-në se natyra dhe shkalla e kontrollit për të përcaktuar nëse efektshmëria e hetimeve plotëson minimumin e kërkuar varet nga rrethanat e rastit të caktuar. Për këto arsye, Paneli konsideron se për çdo rast veç e veç duhet të përcakton nëse janë ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për realizimin e hetimit të efektshëm, ashtu siç parashihet në nenin 2, duke marrë parasysh realitetin e punës hetimore në Kosovë.

d) Përputhshmëria me nenin 2 në rastin në fjalë

93. PSSP-ja deklaron se është bërë hetim i efektshëm lidhur me kidnapimin dhe vrasjen e Ah.C. dhe An.C.; megjithatë, për shkak të informatave dhe pistave hetimore minimale, nuk kanë mundur të arrihen rezultate konkrete.

94. Ankuesja deklaron se kidnapimi i bashkëshortit dhe djalit të saj menjëherë i është raportuar KFOR-it, KNKK-së dhe UNMIK-ut. Duke mos pasru dokumente specifike lidhur me këtë, Paneli konsideron se UNMIK-u njoftua për kidnapimin e Ah.C. dhe An.C.'s më së voni në gusht të vitit 2000. Më këtë datë, KNKK-ja ka lëshuar kërkesat për gjurmim, ndërsa MPU e Policisë së UNMIK-ut ka hapur hetimet.

95. Paneli vëren se ka pasur mangësi të dukshme në realizimin e hetimeve që nga fillimi i tyre. Megjithatë, në bazë të konsideratave të shqyrtuara më lartë lidhur me juridiksionin e tij të kufizuar kohor (shih § 55), Paneli përkujton se është kompetent *ratione temporis* për të vlerësuar përputhshmërinë e hetimeve me nenin 2 të KEDNj-së vetëm për periudhën pas 23 prillit 2005, duke marrë njëkohësisht parasysh gjendjen e lëndës në atë datë (*Paliq kundër Bosnje Hercegovinën*, cituar në § 81 më lartë § 70). Periudha që shqyrtohet përfundon më 9 dhjetor 2008, kur EULEX-i merr përgjegjësinë në fushën e administrimit të drejtësisë (shih § 20 më lartë).

96. Paneli vëren se që nga regjistrimi i lëndës e deri në janar të vitit 2002, duket se Policia e UNMIK-ut nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për gjetjen e vendndodhjes së anëtarëve të familjes së ankueses ose për identifikimin e personave përgjegjës për zhdukjen e tyre. Nga ankuesja, dëshmitarët e zhdukjes apo nga anëtarët e tjerë të familjes asnjëherë nuk është marrë ndonjë deklaratë. Nuk janë bërë përpjekje që të kërkohet për dëshmi (p.sh. vetura e viktimave) ose ndjekja e pistave të dukshme të hetimeve (p.sh. komandantët e UÇK-së në zonën e Prizrenit). Gjatë vitit 2002, i vetmi hap i ndërmarrë nga UNMIK-u ishte regjistrimi i informatave ante-mortem lidhur me Ah.C. dhe An.C., të cilat i kishte marrë KNKK-ja. Mes janarit dhe marsit 2003, MPU pati sukses në identifikim e kufomave të Ah.C. dhe An.C., të cilat më parë ishin gjetur dhe analizuar nga TNPJ, si dhe i ishin dorëzuar familjes. Edhe pse kjo në vetvete duhet të konsiderohet si një e arritur, Paneli përkujton se obligimi procedural sipas nenit 2 nuk ka përfunduar me gjetjen e kufomave, posaçërisht pasi që ato tregonin shenja të vdekjes së dhunshme. Paneli thekson se ky ka qenë momenti i ripërtëritjes së kontaktit me familjen. Pavarësisht kësaj, nuk është ndërmarrë ndonjë veprim tjetër hetimor për identifikimin e kryerësve deri në momentin kur një raport penal nga Serbia nxiti regjistrimin e rastit në NjHKL të Policisë së UNMIK-ut dhe shqyrtimin e tij në prill të vitit 2005.

97. Duke ardhur në periudhën që hyn brenda juridiksionit të tij, me fillim nga 23 prilli 2005, Paneli thekson se hapat themelorë hetimorë, siç janë intervistomi i ankueses dhe i dëshmitarëve të kidnapimit ende nuk ishte bërë. Përveç kësaj, Paneli konsideron se pasi që personat përgjegjës për krimin nuk ishin gjetur, UNMIK-u ka qenë i obliguar të përdorë mjetet në dispozicion për të shqyrtuar rregullisht përparimin e hetimeve dhe për të siguruar daljen në dritë të fakteve të reja, si dhe për të njoftuar të afërmit e Ah.C. dhe An.C përkitazi me çfarëdo piste të re të hetimeve. Paneli vëren se rasti, i cili në ndërkohë ishte cilësuar si "joaktiv" në pritje të informatave të reja, është shqyrtuar në tetor dhe nëntor të vitit 2007. Megjithatë, Paneli konsideron se të dy shqyrtimet kanë qenë larg nga të qenit të duhura. Në fakt, hetuesit shqyrtues nuk kanë identifikuar mangësitë evidente të hetimeve dhe kanë raportuar gabimisht se Ah.C. dhe An.C. ishin ende të zhdukur (shih §§ 45-47 më lartë).

98. Rrjedhimisht, Paneli konsideron se duke u bazuar në të gjitha rrethanat e rastit në fjalë, UNMIK-u nuk ka ndërmarrë të gjithë hapat për të identifikuar kryerësit dhe për t'i sjellë ata para drejtësisë. Në këtë kuptim, Paneli konsideron se hetimet nuk kanë qenë të duhura dhe nuk kanë qenë në përputhje me kriteret e urgjencës, shpejtësisë dhe efektshmërisë (shih § 81 më lartë), ashtu siç parashihet në nenin 2.

99. Sa i përket kushtit për kontroll publik, Paneli përkujton se neni 2 gjithashtu parasheh që i afërmi i viktimës të përfshihet në hetime në shkallën e nevojshme me qëllim të ruajtjes së interesave të tij legjitime.

100. Ankuesja thotë se nuk ka marrë informata nga UNMIK-u lidhur me hetimet për bashkëshortin dhe djalin e saj. Paneli thekson, se në bazë të informatave të parashtruara nga Paneli, familja e ankueses (djali i saj) është kontaktuar nga UNMIK-u vetëm njëherë me rast të dorëzim-pranimit të kufomave të zotërinjve Ah.C. dhe An.C. në vitin 2003. Siç ka theksuar tanimë Paneli, asnjë deklaratë nuk është marrë nga ankuesja dhe asnjë informatë nuk i është dhënë lidhur me gjendjen e procesit të hetimeve, duke përfshirë edhe informatën se rasti në vitin 2005 ishte klasifikuar si "jokativ". Andaj Paneli konsideron se hetimet nuk kanë qenë të qasshme për familjen e ankueses, ashtu siç parashihet në nenin 2.

101. Duke marrë për bazë dobësitë dhe mangësitë e përshkruara më lartë, Paneli vjen në përfundim se UNMIK-u nuk ka bërë hetim të duhur dhe të efektshëm për kidnapimin dhe vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të ankueses. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të nenit 2 të KEDNj-së.

C. Shkelja e pretenduar e nenit 3 të KEDNJ-së

102. Ankuesja thotë se mungesa e informatave dhe pasiguria rreth zhdukjes dhe vrasjes së bashkëshortit dhe djalit të saj i kanë shkaktuar asaj dhe familjes së saj vuajtje shpirtërore. Paneli konsideron se ankuesja mund të thuhet që thirret në shkeljen e nenit 3 të KEDNj-së, përmes të cilit ndalohet trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues.

103. PSSP-ja nuk parqet komente të tjera me referencë specifike në shkeljen e pretenduar të nenit 3 të KEDNj-së.

104. Në vendimin e tij të datës 9 shtator 2010, Paneli ka shpallur ankesën si të pranueshme. Megjithatë, Paneli duhet të rivlerësojë pranueshmërinë e kësaj pjese të ankesës, duke marrë parasysh zhvillimet pasueses të praktikës së punës së Panelit përkitazi me pranueshmërinë e ankesave sipas nenit 3 të KEDNj-së.

105. Në veçanti, Paneli thekson se në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, anëtari i familjes së personit të zhdukur, në rrethana të caktuara mund të konsiderohet viktimë e trajtimit nga ana e autoriteteve që shkon në kundërshtim me nenin 3 të KEDNj-së, përmes të cilit ndalohet trajtimi çnjerëzor. Në rastet kur personi i zhdukur më vonp gjendet i vdekur, zbatueshmëria e nenit 3 në parim është e kufizuar në peridhpn e caktuar, gjatë së cikës anëtari i familjes ka pasur pasiguri, ankth dhe shqetësim që lidhet me fenomenin specifik të zhdukjeve (shih p.sh: GjEDNj, *Luluyev dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 69480/01, aktgjykim i datës 9 nëntor 2006, §§ 114-115, *GjEDNj*, 2006-XIII ; shih gjithashtu GjEDNj, *Gongadze kundër Ukrainës*, nr. 34056/02, aktgjykim i datës 8 nëntor 2005, § 185, GjEDNj, 2005-XI).

106. Për rastin në fjalë, periudha relevante ka zgjatur deri më 6 mars 2003, kur mbetjet mortore të Ah.C. dhe An.C. i janë dorëzuar familjes së ankueses.

107. Paneli tanimë ka përkujtuar se në bazë të nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 ka juridiksion vetëm ndaj "ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur jo më herët se më datën 23 prill 2005 apo që dalin nga faktet, të cilat kanë ndodhur para kësaj date, në rastet kur këto fakte ngrisin shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut".

108. Paneli nuk ka dyshime për vuajtjet e thella të shkaktuara ndaj ankueses nga zhdukja dhe vdekja e të afërmve të saj. Megjithatë, Paneli duhet të konstatojë se kjo pjesë e ankesës mbetet jashtë juridiksionit *ratione temporis* (shih PKDNj, *Patrnogić,* nr. 252/09, vendim i datës 16 dhjetor 2011, §§ 16-20) dhe për këtë arsye shpallet e papranueshme.

V. KOMENTET DHE REKOMANDIMET PËRMBYLLËSE

109. Duke u bazuar në gjetjet e Panelit për këtë lëndë, Paneli është i mendimit se ka nevojë për një lloj të kompensimit.

110. Paneli thekson se zhdukjet e dhunshme dhe vrasjet arbitrare përbëjnë shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, të cilat autoritetet kompetente janë të obliguara t'i hetojnë dhe t'i sjellin kryerësit para drejtësisë në të gjitha rrethanat. Paneli po ashtu thekson se në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, nga viti 1999 deri në vitin 2008 UNMIK-u kishte përgjegjësinë kryesore për të hetuar dhe ndjekur penalisht në mënyrë të efektshme zhdukjen dhe vrasjen e Ah.C. dhe An.C., dhe dështimi i tij për ta bërë një gjë të tillë përbën shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut të viktimave dhe të të afërmve të tyre, në veçanti, të së drejtës së përcaktimit të vërtetës për këtë çështje.

111. Paneli merr parasysh shqetësimet e PSSP-së për atë se resurset jo të duhura, posaçërisht në fillim të misionit të UNMIK-ut, e bën respektimin e obligimeve të UNMIK-ut për të drejtat e njeriut vështirë të arritshëm.

112. UNMIK-u me rregull do të duhej të ndërmerrte masat e duhura për të ndalur shkeljen e vërejtur dhe për të rregulluar sa më shumë që të jetë e mundur efektet e saj. Megjithatë, ashtu siç ka theksuar Paneli më lartë (shih § 20), përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me administrimin e drejtësisë në Kosovë ka përfunduar më 9 dhjetor 2008, me ç'rast EULEX-i ka marrë kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit. Andaj, UNMIK-u më nuk është në pozitë që të ndërmerr masa, të cilat do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë në hetimet që janë ende në vazhdim e sipër para autoriteteve të EULEX-it apo të atyre lokale. Gjithashtu, pas shpalljes së pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë më 17 shkurt 2008, UNMIK-u më nuk zbaton funksione ekzekutive në Kosovë, fakt ky që kufizon aftësinë e tij për të ofruar kompensim të plotë dhe të efektshëm për shkeljen e kryer, ashtu siç parashihet në parimet e konsoliduara të së drejtës ndërkombëtare për të drejta të njeriut.

113. Paneli konsideron se kjo gjendje faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi i tij për të rregulluar sa më shumë që të jetë e mundur efektet e shkeljeve, për të cilat është përgjegjës.

Lidhur me ankesën dhe lëndën në përgjithësi Paneli e konsideron të duhur që UNMIK-u:

- Në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut lidhur me juridiksionit e kufizuara shtetërore (shih GjEDNj (Dhoma e lartë), *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, aktgjykim i datës 8 korrik 2004, *GjEDNj*, 2004-VII, § 333; GjEDNj, *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, aktgjykim i datës 2 mars 2010, § 171; GjEDNj (Dhoma e lartë), *Catan dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 43370/04, 8252/05 dhe 18454/06, aktgjykim i datës 19 tetor 2012, § 109), të përpiqet, me të gjitha mjetet diplomatike që i ka në dispozicion ndaj EULEX-it dhe autoriteteve të Kosovës, të merr garanci se hetimet lidhur me rastin në fjalë do të vazhdohen në përputhje me kushtet e një hetimi të efektshëm, ashtu siç parashihet në nenin 2, që rrethanat e zhdukjes dhe vrasjes së Ah.C. dhe An.C. të përcaktohen dhe që kryerësit të vihen para drejtësisë; ankuesja dhe/ose të afërmit të njoftohen për këto procedura dhe, sipas nevojës dokumentet relevante t'iu paraqiten;

- Brenda një kohe të arsyeshme, të pranojë publikisht përgjegjësinë lidhur me dështimin e UNMIK-ut që të hetojë në mënyrë të duhur zhdukjen dhe vrasjen e Ah.C. dhe An.C dhe t'i kërkojë falje publike ankueses dhe familjes së saj në këtë aspekt.

- Të ndërmerr hapa të duhur drejt pagesës së kompensimit të duhur ankueses për dëmin moral të shkaktuar për shkak të dështimit të UNMIK-ut për të kryer hetim të efektshëm, siç është cekur më lartë.

Paneli gjithashtu e konsideron të udhës që UNMIK-u:

- Në përputhje me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme për "Parimet dhe udhëzimet bazë për të drejtën në mjet të efektshëm dhe në kompensim të viktimave të shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut" (A/Res/60/147, të datës 21 mars 2006), të ndërmerr hapa të duhur, përmes organizatave të tjera të OKB-së në Kosovë, organeve vendore dhe organizatave joqeveritare, për realizmin e programit të reparacionit të plotë dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë restituimin, kompensimin, rehabilitimin, kënaqjen dhe garancitë për mospërsëritje për viktimat e të gjitha komuniteteve të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, të cilat kanë ndodhur gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë dhe pas tij;

- Të ndërmerr hapa të duhur para organeve kompetente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë edhe Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, për ndarjen e resurseve të duhura njerëzore dhe financiare për ta siguruar respektimin në çdo kohë të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga ana e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë edhe atëherë kur zbaton funksioneve administrative dhe ekzekutive në një territor, si dhe të organizojë monitorimin e efektshëm dhe të pavarur.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

1. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË OBLIGIMIT PROCEDURAL SIPAS NENIT 2 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT;

2. KONSTATON SE ANKESA E BAZUAR NË NENIN 3 ËSHTË E PAPRANUESHME;

3. REKOMANDON QË UNMIK-U:

a. TË NXISË EULEX-IN DHE AUTORITETET E TJERA KOMPETENTE NË KOSOVË QË TË NDËRMARRIN TË GJITHË HAPAT E MUNDSHËM PËR T'U SIGURUAR QË HETIMET PENALE PËR ZHDUKJEN DHE VRASJEN E ANËTARËVE TË FAMILJES SË ANKUESES TË VAZHDOHEN NË PËRPUTHJE ME NENIN 2 TË KEDNJ-S DHE QË KRYERËSIT TË VIHEN PARA DREJTËSISË;

b. TË PRANOJ PUBLIKISHT PËRGJEGJËSINË PËR DËSHTIMIN E TIJ NË REALIZIMIN E HETIMEVE TË EFEKTSHME PËR ZHDUKJEN DHE VRASJEN E ANËTARËVE TË FAMILJES SË ANKUESES DHE QË T'I KËRKOJË FALJE PUBLIKISHT ANKUESES DHE FAMILJES SË SAJ;

c. TË NDËRMERR HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT TË DUHUR TË ANKUESES PËR DËMIN MORAL;

d. TË NDËRMERR HAPA TË DUHUR DREJT REALIZIMIT TË NJË PROGRAMIT TË PLOTË DHE GJITHËPËRFSHIRËS TË REPARACIONIT;

e. TË NDËRMERR HAPA TË DUHUR NË ORGANIZATËN E KOMBEVE TË BASHKUARA SI GARANCI PËR MOSPËRSËRITJE;

f. TË NDËRMERR MASA TË MENJËHERSHME DHE TË EFEKTSHME PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT, SI DHE TË NJOFTOJË ANKUESEN DHE PANELIN PËR ZHVILLIMET E TJERA LIDHUR ME KËTË RAST.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues

Shtojca

SHKURTESAT

NjQHP – Njësia Qendrore e Hetimeve Penale
KNDCP – Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike
DD – Departamenti i Drejtësisë
ZPPQ – Zyra e Prokurorit Publik të Qarkut
KEDNj – Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut
GjEDNj – Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut
BE – Bashkimi Evropian
EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
RFJ – Republika Federale e Jugosllavisë
PKDNj – Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut
KDNj – Komisioni për të Drejta të Njeriut i Kombeve të Bashkuara
GjNDNj – Gjykata Ndëramerikane për të Drejta të Njeriut
KNDCP – Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike
KNPZh – Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur
KNKK – Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
TNPJ – Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi
KFOR – Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (zakonisht e njohur si Forcë e Kosovës)
UÇK – Ushtria Çlirimtare e Kosovës
MiM – Memorandum i Mirëkuptimit
NjPZh – Njësia për Persona të Zhdukur
NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
ZPZhML – Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
NjRH – Njësia Regjionale e Hetimeve
PSSP- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNHCR – Komisioneri i Lartë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
KGjIV – Komisioni për Gjetjen dhe Identifikimin e Viktimave
NjHKL – Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës